



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** e Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. Nr. 110 – 391, t137 dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 31.3.2026, merr këtë:

**V E N D I M**

**PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE KLUBIT TË FUTSALIT  
“PRISHTINA 01 – FUTSAL” PËR PROJEKTIN “ FC PRISHTINA 01 – FUTSAL”  
PËR SEZONIN SPORTIV 2025**

- I. Miratohet vendimi për ndarjen e mjeteve financiare KF “Prishtina 01- Futsal”, për projektin “FC Prishtina 01- Futsal”, për sezonin sportiv 2025.
- II. Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është **20,000.00 €** (njëzetë mijë euro), shumë kjo e siguruar nga kodi buxhetor i Drejtorisë së Sportit 85086.
- III. Qëllimi i këtij Vendimi është ndarja e mjeteve financiare si në pikën II, KF “Prishtina 01- Futsal”, të cilat Komuna e Prishtinës i ndan si mbështetje financiare për zhvillimin e lojtarëve të rinj dhe promovimin e futbollit në komunitet, duke përfshirë trajnime të rregullta, gara vendore dhe ndërkombëtare, si dhe aktivitete edukativo-sportive për të rinjtë.
- IV. Pjesë e këtij vendimi është kërkesa me dokumentet përcjellëse, e KF “Prishtina 01 – Futsal”.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe drejtoritë e tjera relevante.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditën pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administratës të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT**  
01-400/04-48087/26, më 02.4.2026

**KRYESUES I KUVENDIT**  
Fehmi Kupina

